

VENDIM
Nr. 36, datë 19.1.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 554, DATË 31.7.2019,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN, MËNYRËN E ORGANIZIMIT
DHE TË FUNKSIONIMIT TË AGJENCISË KOMBËTARE TË PUNËSIMIT DHE
AFTËSIVE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 14, pika 3, dhe 15, pika 6, të ligjit nr.15/2019, “Për nxitjen e punësimit”, të pikës 3, të nenit 9, të ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”, si dhe të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në kreun III, të vendimit nr. 554, datë 31.7.2019, të Këshillit të Ministrave, bëhen disa ndryshime dhe shtesa:

a) Pika 11 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“11. Marrëdhëniet e punës së nëpunësve në drejtorinë qendrore të AKPA-së rregullohen në bazë të dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë në drejtorinë qendrore të AKPA-së rregullohen në bazë të dispozitave të Kodit të Punës.”;

b) Pas pikës 11 shtohen pikat 11/1, 11/2, 11/3 dhe 11/4, me këtë përmbajtje:

“11/1 Drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së emërohet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për punën. Drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së duhet të plotësojë kriteret, si më poshtë vijon:

a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;

b) të ketë diplomë të nivelit “Master shkencor” apo “Master profesional”, të përfutur në fund të studimeve të ciklit të dytë me 120 (njëqind e njëzet) kredite dhe me kohëzgjatje normale 2 (dy) vite akademike ose të barasvlershme me to, sipas legjislacionit për arsimin e lartë;

c) të ketë përvojë në profesion të paktën 3 (tri) vite;

ç) të shquhet për figurë të pastër etiko-morale;

d) të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake;

dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga puna, që nuk është shuar sipas legjislacionit në fuqi;

e) të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;

ë) të mos ketë konflikt interesi me detyrën në përputhje me legjislacionin në fuqi për konfliktin e interesave.

11/2 Procedura e përzgjedhjes së kandidaturës për t’u propozuar për emërim nga Këshilli i Ministrave si drejtor i Përgjithshëm i AKPA-së, miratohet si pjesë e rregullores për metodat e brendshme të punës dhe sjelljen e personelit të AKPA-së.

11/3 Drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së lirohet nga detyra, kur:

a) plotëson moshën për pensionin e plotë të pleqërisë;

b) dënohet me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;

c) deklarohet i paaftë për punë nga komisioni kompetent mjekësor;

- ç) gjendet në një situatë të konfliktit të vazhdueshëm të interesit;
- d) jep dorëheqjen nga detyra.

11/4 Drejtori i Përgjithshëm i AKPA-së shkarkohet nga detyra, kur:

- a) konstatohen shkelje të dispozitave të legjislacionit në fuqi, përfshirë legjislacionin specifik mbi bazë të të cilit ushtron veprimtarinë AKPA-ja;
- b) kryen veprimtari që krijon konflikt interesi;
- c) zbulohen raste të papajtueshmërisë së funksionit të tij;
- ç) kryen shkelje të rënda gjatë kryerjes së detyrës;
- d) vërtetohet se ka përgjegjësi për mosrealizimin e objektivave të vendosur për AKPA-në.”.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama